UDHËZIM
Nr. 116, datë 11.7.2024

PËR PROCEDURAT DHE FORMULARIN E REGJISTRIMIT E TË HUAJIT NË REGJISTRIN KOMBËTAR TË GJENDJES CIVILE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 36, të ligjit nr. 79/2021 "Për të huajt",

UDHËZOJ:

1. I huaji, i cili ka marrë njoftimin për miratimin e Lejes së Qëndrimit ose Unike, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, ka detyrimin të paraqitet pranë Zyrës së Gjendjes Civile ku ka vendosur vendbanimin e tij të përkohshëm, duke paraqitur dokumentacionin, si vijon:

a) njoftimin sipas modelit në aneksin 1, të këtij udhëzimi;

b) dokumentin e udhëtimit me të cilin ka hyrë dhe qëndron në Shqipëri;

c) fotokopje e noterizuar e kontratës së qirasë, apo të një dokumenti që tregon që ka në pronësi një banesë.

2. Me paraqitjen në zyrën e Gjendjes Civile, të dhënat e të huajit aktivizohen në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC), duke mundësuar fillimin e procesit të aplikimit për dokument biometrik, leje qëndrimi/leje unike për të huajt.

3. Në rast të ndryshimit të vendbanimit të të huajit, deklarimi për ndryshimin e vendbanimit duhet të bëhet nëpërmjet portalit *e-Albania*, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga ardhja në vendbanimin e ri.

4. Kur të huajit i përfundon afati i lejes së qëndrimit apo lejes unike, të dhënat e tij automatikisht çaktivizohen në RKGJC, brenda një muaji nga përfundimi i lejes së qëndrimit/lejes unike.

5. Në rastin kur i huaji largohet nga territori i Republika e Shqipërisë, apo i anulohet leja e qëndrimit për arsye të ndryshme, strukturat përgjegjëse të migracionit pranë autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin, njoftojnë strukturat përgjegjëse të migracionit pranë autoritetit qendror për kufirin dhe migracionin, të cilat marrin masa për anulimin e lejes së qëndrimit në sistemin FER. Ky njoftim i shkon automatikisht Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile. Ndryshimi i statusit të shtetasit të huaj në RKGJC ndodh automatikisht, duke u ndryshuar nga "aktiv" në "i bllokuar".

6. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet pasi të pasqyrohen zhvillimet përkatëse teknike në portalin *e-Albania.*

MINISTËR I BRENDSHËM
Taulant Balla

ANEKSI NR. 1

DEPARTAMENTI PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
DREJTORIA VENDORE PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN _____

NJOFTIM

Ju njoftojmë se leja e qëndrimit/leja unike për shtetasin _____, me dokument udhëtimi nr._____, FID_____ është miratuar.

Për lëshimin e dokumentit biometrik leje qëndrimi/unike, ju duhet të:

Hapi 1: Konfirmoni adresën e saktë të banimit në Zyrën e Gjendjes Civile (duke paraqitur brenda 30 ditëve këtë njoftim të printuar, dokumentin e udhëtimit dhe kontratën e qirasë së banesës).

Hapi 2: Kryeni pagesën për vlerën e kartës biometrike, duke blerë kuponin në zyrat e Postës Shqiptare

Hapi 3: Paraqiteni në Drejtorinë Vendore për Kufirin dhe Migracionin ose Komisariatin e Policisë Kufitar dhe Migracionit_____, për të kryer procedurën e pajisjes me kartën biometrike leje qëndrimi/leje unike për të huajt.

Faleminderit për mirëkuptimin!

Specialist i Migracionit_____

Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin/Komisariati i Policisë Kufitare dhe Migracionit_____

NOTE

We inform you that your Residence Permit/Single Permit for citizen _____, Travel Document no._____, FID_____ has been approved.

To issue a biometric document Residence Permit/Unique Permit, you need:

Step 1: *Confirm the correct residential address at the Civil Registry Office (submitting this printed notice, travel document and apartment rental contract within 30 days).*

Step 2: *Make the payment by buying the coupon at the Post Office*

Step 3: *Be present at the Local Director for Border and Migration or Border and Migration Commissariat _____ to perform the procedure for equipment with the biometric card Residence Permit for Foreigners.*

Thank you for understanding!

Id Code/20220105/2534510

Migration Specialist _____*Local Director for Border and Migration or Border and Migration Commissariat _____*